



**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE**  
**MASTER PROFESIONAL: PROFILI "DREJTIM TURIZMI"**



**Tema:**

**VLERËSIMI TURISTIK I POTENCIALIT NATYROR DHE KULTUROR I NJË  
DESTINACIONI**

**(Rast Studimi Saranda)**

**DIPLOMANTI:**

**Velika BUDINI**

**UDHËHEQËSI:**

**Prof. Dr. Elmas LECI**

*Durrës, 2013*

## ABSTRACT

*Increasing trend turtistike movement and the development of host tourist destinations, have made it necessary to use tourism elements successfully. Tourism is a dream factory, where the dreams for the trip activities and managed events come true. The purpose of this topic is to provide a definition of Sarande tourism. Through theoretical aspects and analysis shows how to give priority to the entertainment side of tourism, recreation, cultural and health tourists and economic development of the region. In this paper we will show why tourism in the Saranda is so developed and why Saranda constitutes the most liked area in southern riviera by the tourists and being called "the tourist destination". Rich archaeological heritage combined with the beauty of nature and its natural port, constitutes the most important basis for promoting the development of the current image of Saranda, a classic worldwide tourist destination, as well as to attract particular tourist market. Given the natural potential that owns Saranda offers several forms of tourism, characterized by different reasons, but the main product is that to the "rest" story. As a result of the improvement of tourism infrastructure has also increased the time stay of tourists whether they are foreign or domestic. Tourism is a phenomenon with a democratic character. He serves on the recognition of countries and people of different social categories and nationalities.*

## ABSTRAKT

*Prirja në rritjen e lëvizjes turtistike si dhe zhvillimi i shumë destinacioneve turistike pritëse, kanë bërë të domosdoshëm përdorimin e elementeve të turizmit në mënyrë të suksesshme. Turizmi është një fabrikë ëndrrash, veprimtari ku ëndrrat për udhëtimin bëhen realitet dhe menaxhohen si ngjarje. Qëllimi i kësaj teme është që të jepet një përcaktim të turizmit të Sarandës. Nëpërmjet aspekteve teorike dhe analizës tregohet se si ky turizëm i jep përparësi anës argëtuese, rekreative, kulturore dhe shëndetësore të turistëve si dhe asaj ekonomike për zhvillimin e rajonit. Në këtë punim do të tregojmë pse turizmi në Sarandë është kaq i zhvilluar dhe pse Saranda përben zonën më të pelqyer në rivieren e jugut nga ana e turistëve, duke u quajtur "Destinacion turistik". Trashëgimia e pasur arkeologjike e gërshetuar me bukuritë e natyrës, si dhe portin e saj natyral, përben bazën më të rëndësishme për promovuar zhvillimin e imazhit aktual të Sarandës, si një destinacion i turizmit klasik botëror, si dhe për të tërhequr tregun e turizmit të veçantë. Nisur nga potenciali natyror që zotëron Saranda ofron disa forma të turizmit, të karakterizuara nga motive të ndryshme, por produkti më kryesor është ai mbi motivin "pushim". Si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës turistike është rritur edhe kohëqëndrimi i turistëve qofshin ata të huaj apo vendas. Turizmi është dukuri me karakter demokratik. Ai shërben për njohjen e vendeve dhe të personave, kategorive të ndryshme shoqërore dhe kombeve të ndryshme.*

**Fusha:** Turizmi

**FJALËT KYÇE:** turizmi, potencial, destinacion, trashëgimni


## MIRËNJOHJE

Një mirenjohje shkon për UAMD-në që krijoi mundësinë për të studiuar në profilin ku unë dëshiroja dhe që e kam me shumë pasion.

Mirënjohje dhe falenderim për të gjithë lektorët e kurseve që u zhvilluan në Masterin Profesional, profili “Drejtimit Turizmi”.

Mirënjohje gjithashtu për të gjithë anëtarët e grupit dhe një falenderim i veçantë për udhëheqësin shkencor Prof.Dr. Elmas Leci, i cili me sygjërimet e t’ija ka dhënë një ndihmesë të madhe në punimin tim të diplomës.

Gjithashtu falenderoj dhe Familjen time për mbështetjen e madhe që më ka dhënë gjatë studimeve të mia.



## **PËRMBAJTJA:**

<b>Hyrja</b>	faqe 5
<b>Kreu I</b>	
<b>Pse Saranda është destinacion turistik</b>	faqe 10
1.1. Potenciali natyror dhe kulturor të Sarandës	faqe 10
1.2. Produktet turistike që ofron Saranda	faqe 18
<b>Kreu II</b>	
<b>Zhvillimi i lëvizjes turistike në Sarandë ndër vite</b>	faqe 28
2.1. Analiza e qarkullimit turistik në Sarandë në disa vite	faqe 29
2.2. Turistë vendas dhe të huaj të përfshirë në lëvizjen turistike	faqe 30
<b>Kreu III</b>	
<b>Problematika e turizmit në Sarandë në të ardhmen</b>	faqe 33
<b>Përfundime</b>	faqe 42
<b>Rekomandime</b>	faqe 43
<b>Bibliografia</b>	faqe 44

## HYRJA

Turizmi është një industri e cila po arrin sukses tepër të madhë anë e mbanë nëpër botë. Është një ndër industritë e cila angazhon shumë sektorë të tjerë dhe njëkohësisht i shpërndan të ardhurat, duke mos i mbajtur vetëm në sektorin e saj. Shtete të ndryshme apo edhe individë të veçantë duke parë ndikimet e shumta që turizmi kishte në shoqërinë e një vendi, filluan të interesoheshin në masë të madhe. Edhe vendi ynë nuk ngeli pas në zhvillimin e turizmit. Shteti apo privati si dhe institucione të veçanta filluan të punonin ndjeshëm në këtë sektor. Filluan investimet e shumta në infrastrukturë (ujsjellës, spitale, telekomunikacioni etj), gjithashtu investimet u bënë edhe nga sektori privatit të cilët hodhën shumta të mëdha parash në ndërtimin e hoteleve, shtëpive të fshatit, kampingje të ndryshme etj. Pra, kemi një përfshirje të madhe në sektorin e turizmit si nga ana e shtetit edhe nga ndërmarrjet private, qofshin këta individ, firma të ndryshme etj.

Por në këtë gjithpërfshirje kemi një luhatje të madhe përse i përket numrit të turistëve, (ritje dhe ulje të numërit të turistëve në një masë të ndjeshme). Strukurat hoteliere, të cilat janë një pjesë shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme për turizmin po ofrojnë forma të ndryshme shërbimesh për ta “joshur” klientin dhe për ta rikthyer sërish. Por lindin një sërë pyetjesh si:

1. A i plotëson destinacioni ynë për tu quajtur destinacion turistik?
2. Sa rëndësi po i kushtohet shërbimit të klientit?
3. A është ky shërbim në nivelet e duhura, apo ne thjesht ju shërbejmë për momentin.
4. Në çfarë niveli ofrohet cilësia e shërbimit?.....

Turizmi sot shihet si një zhvillim cilësor i industrisë turistike, si në lidhje me të mirat dhe shërbimet turistike të ofruara, ashtu edhe me organizimin dhe drejtimin e vetë biznesit në këtë sektor. Prirja në rritjen e lëvizjes turistike si dhe zhvillimi i shumë destinacioneve turistike pritëse, kanë bërë të domosdoshëm përdorimin e elementeve të turizmit në mënyrë të suksesshme. *Turizmi është një fabrikë ëndrrash, veprimtari ku ëndrrat për udhëtim bëhen realitet dhe menaxhohen si ngjarje.*

Turizmi merr kuptime të ndryshme, ai është një përmbledhje marrëdhëniesh, dhe dukurish me dy karaktere të veçanta: shoqërore (dukuri prodhimi dhe konsumi), si dhe ekonomike, ku, përparësi i jepet anës ekonomike të tij, dhe me pas vijnë aspekte argëtuese, kulturore, shëndetësore etj.

Pavarësisht nga cili aspekt merret turizmi ai, në të dyja rastet sjell përfitime, sepse nga njera anë njeriu mundet të kalojë në mënyrë sa më të volitshme kohën e lirë, si dhe të informohet nga ana kulturore etj. Turizmi sjell qarkullimin e valutës në turizmin ndërkombëtar, gjë që çon në rritjen e bilancit të vendit. Turizmin mund ta klasifikojmë mbi bazën e motiveve nxitëse, ku kemi: turizmin natyralistik, turizmin klimatik, turizmin detar, turizmin lumor, turizmin e bardhë, turizmin rural, turizmin kulturor etj.

Një lloj turizmi ku turistët gjejnë qetësi nga ana psikike është dhe turizmi detar, i cili mund të zhvillohet si turizmi i banjave detare, turizmi i sporteve ujore si dhe turizmi natyror i cili zhvillohet në mal dhe në bregdet. Saranda paraqet mundësi për të qenë një destinacion i zhvillimit të disa llojeve të turizmit, kjo falë një mjedisi relativisht të pandotur, një natyrë spektakolare e që ndërthur harmonishëm pejsazhin natyror, kulturor dhe atë bregdetar.

Qëllimi i kësaj teme është që të jepet një përcaktim të turizmit të Sarandës. Nëpërmjet aspekteve teorike dhe analizës tregohet se si ky turizëm i jep përparësi anës argëtuese, rekreative, kulturore dhe shëndetësore të turistëve si dhe asaj ekonomike për zhvillimin e rajonit. Turizmi në Sarandë jep përfitime të mëdha sepse nga njera anë një turist mund të kalojë kohën e lirë në mënyrë sa më të kendshme, ndërsa nga ana tjetër, turizmi në Sarandë sjell qarkullimin e valutës gjë që çon në rritjen e të ardhurave në Sarandë.

Në këtë punim do të tregojmë pse turizmi në Sarandë është kaq i zhvilluar dhe pse Saranda përben zonën me të pelqyer në rivieren e jugut nga ana e turistëve, duke u quajtur ‘Destinacion turistik’. Një destinacion turistik përdor një shumëllojshmeri elementesh të ndërvarura. këto elemente janë të pranishëm në prodhimin e produktit për kenaqjen e nevojës së turistëve. Destinacioni turistik i parë si një produkt i cili përbehet nga: atraksionet, strukturat akomoduese, infrastruktura, transporti, dhe shumë elemente të tjerë, tipi dhe numri i të cilëve varet nga nevojat dhe dëshirat e turistave. Gjithashtu në këtë punim do të analizojmë edhe mangesitë që mund të ndeshen dhe që përmiresimi i tyre do të bënte akoma më të njohur dhe më të kërkuar këtë destinacion nga ana e turistëve.



## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **Kreu I: Pse saranda është destinacion turistik?**

Në kreun e parë trajtohet pse Saranda është një destinacion turistik cili është potenciali natyror dhe kulturor, që e bën Sarandën destinacion turistik, cilat janë produktet turistike që ofron Saranda.

### **Kreu II: Zhvillimi i lëvizjes turistike në sarandës ndërvite**

Në kreun e dytë trajtohet historia e qarkullimit dhe e lëvizjes turistike në Sarandë, analizohet e qarkullimi turistik në Sarandë në vite, si ka ndryshuar me uljet dhe ngritjet ne vite të ndryshme nepermjet statistikave të mara nga Ministria e Turizmit, si dhe Zyra e Shërbimit Turistik Sarandë.

### **Kreu III. Problematika e turizmit në Sarandë në të ardhmen**

Në kreun e tretë trajtohen si e kanë zbuluar Sarandën si destinacion turistik? Çfarë ofron Saranda për turistin e huaj dhe sa janë shpenzimet që ata bëjnë gjatë një dite, të cilat janë disa nga pyetjet e bëra nëpërmjet një pyetsori drejtuar disa turistëve gjatë një studimi që kemi bërë.



## QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i kësaj teme është kuptimi apo dhënia e rëndësisë së duhur menaxhimit të burimeve natyrore dhe kulturore-historike të një vendi për ta bërë një destinacion turistik pritës të suksesshëm në tregun turistik. Sot vihet re se edhe pse turizmi ka marrë një zhvillim të vullshëm akoma në vendin tonë nuk ka filluar të kuptohet dhe të vlerësohet rëndësia që ka menaxhimi i suksesshëm. Gjithashtu ky punim ka si qëllimi të evidentojë zhvillimin e sektorit të turizmit në një hapësirë të caktuar siç është rajoni i Sarandës, të analizojë potencialin natyror dhe kulturor që posedon një vend dhe të përcaktojë se kur ky vend quhet turistik. Nëpërmjet analizës së flukseve turistike të realizuara në Sarandë nëpër vite punimi evidenton faktorët e ndryshëm të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e Sarandës si destinacion turistik. Nga ky punim synojmë të arrijmë këto objektiva:

- ✚ Vlerësimi turistik i potencialit natyror dhe kulturor të një destinacioni.
- ✚ Ndërgjegjësimi rezidentëve të një destinacioni mbi rëndësinë që ka zhvillimi i turizmit
- ✚ Ndërgjegjësimi i drejtuesve të bizneseve turistike, për të kuptuar se sa i rëndësishëm është menaxhimi me kriter i burimeve turistike.
- ✚ Angazhimi i gjithë aktorëve në vendimmarrjen për zhvillimin e turizmit në një destinacion.

## METODOLOGJIA:

Metodologjia për realizimin e këtij punimi është bazuar në përdorimin e metodave si ajo e hulumtimit, analizës, metoda e vrojtimit, metoda krahasuese etj. Të dhënat dhe informacionet janë siguruar nga burime të ndryshme nga literatura e fushës së turizmit, nga zyra e Statistikës Sarandë, Zyra e Turizmit Sarandë, INSTAT, Ministria e Turizmit, etj. Gjithëashtu si burime sekondare janë përdorur të dhëna të marrë nga studime të mëparshme për rajonin turistik të Sarandës.

## KREU I

### PSE SARANDA ËSHTË DESTINACION TURISTIK?

#### 1. 1. Potenciali natyror dhe kulturor i Sarandës

Saranda është qyteti më i bukur bregdetar në Shqipëri, është një qytet me më shumë se 2000 vjet histori, ngritur në zonën e bregdetit jugor të vendit, i pasur në vlera të rralla të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike shqiptare, por edhe evropiane. Në fillimet e tij qyteti ka shërbyer si një portë për qytetin antik të Fiqinit dhe si rrjedhojë dhe si portë hyrjeje për në rajon. Kjo trashëgimni e pasur arkeologjike e gërshetuar me bukuritë e natyrës, si dhe portin e saj natyral, përben bazën më të rëndësishme për promovuar zhvillimin e imazhit aktual të Sarandës, si një destinacion i turizmit klasik botëror, si dhe për të tërhequr tregun e turizmit të veçantë. Emri Sarandë e ka prejardhjen nga një manastir i vjetër i krishter "Santi Quaranta" Dyzet Shenjtorët. E shtrirë në brigjet e Jonit, përballë ishullit grek "Korfuzi" Saranda është performuar si qytet atraktiv për nga resurset e mundësitë që të ofron. Ajo karakterizohet nga një klimë mesdhetare me ujra të ngrohta detare.

Klima përben një element të rëndësishëm të ofertës natyrore për zhvillimin e turizmit. Rrethi i Sarandës ka një klimë tipike mesdhetare, madje përfaqeson një nga zonat me të ngrohta të Shqipërisë. Fillimi i sezonit të turizmit balnear për zonën bregdetare të Sarandës është më i përshtatshëm për t'u zhvilluar nga fillimi i muajit qershor kur temperatura mesatare është 23°C dhe deri në fund të muajit shtator. Në një vit ka 180 ditë për banja uji. Brigjet e detit Jon në Sarandë formojnë një nga bregdetet më piktoresk të pellgut të Mesdheut, që njihet edhe me emrin Riviera Shqiptare. Ujerat e detit Jon përgjatë bregdetit të Sarandës, janë të pastra, me përjashtim të sektorëve të veçuar me shenja të ndotjes, si pasojë e aktivitetit të njeriut, sidomos ndotje verehet në portin e Sarandës dhe përgjatë shetitores së qytetit, në Ksamil etj.

Liqenet janë pjesë e rëndësishme e ofertës natyrore të këtij destinacioni për zhvillimin e turizmit. Liqenet kryesore të këtij rajoni janë: Liqeni i Butrintit dhe i

Rrezes (ndodhet në lindje të liqenit të Butrintit). Liqeni i Butrintit është më i madhi e më i rëndësishmi. Ai ndodhet në pjesën jugore të rrethit të Sarandës dhe ka origjinë tektonike.

Flora dhe fauna në rrethin e Sarandës përbën interes për turistët që kanë qellime studimi, mjedisore, gjuetie etj. Me vlerat e veçanta që ajo ka përbën një pjesë të rëndësishme të ofertës turistiko-natyrore. Kushtet e favorshme klimatiko-tokesore të Sarandës, kanë bërë që, shkalla e biodiversitetit të jetë shumë e lartë. Prania e detit Jon dhe e liqenit të Butrintit, bëjnë që krahas botës së gjallë që ekziston në tokë, të jetë e pranishme me llojshmërinë e saj edhe bota e gjallë ujore. Përhapja e bimesisë është e kushtëzuar nga disa faktorë, si: temperatura, lloji i tokës, dhe ndikimi i njeriut etj.

Interes ekoturistik paraqet pylli i Butrintit që përbën një xhungël të vërtetë subtropikale ku midis të tjerëve Dafina rritet si dru i lartë dhe përbën pjesën natyrore dekorative të kësaj zonë me rëndësi turistike. Bimësia detare është e larmishme ndërsa ajo e ujërave të ëmbla është pak e pasur dhe gati e njëjlojtë. Si dru i rrallë për bregdetin konsiderohet lloji i Xhixhibanozit. Përsa i përket faunës edhe ajo është e pasur dhe mund të përfshihet shumë lehtë në qarkullimet dhe lëvizjet turistike për tu shndërruar në motiv turizmi. Fauna ujore është e përqëndruar në detin Jon, midhja në liqenin e Butrintit dhe Trofta e Krapit në ujërat e lumenjve. Në Ksamil gjendet edhe një rezervat i botës shtazore.

Zhvillimi ekoturistik mbështetet në objektet, monumentet dhe ekosistemet me vlera të veçanta natyrore. Formacionet gjeologjike, larmia e peizazheve, ujërat, kushtet klimatike dhe prania e bimesisë së veçantë, ndikojnë në ngritjen e komplekseve të ndryshme. Gjithashtu këto pasuri natyrore ndikojnë në rritjen e numrit të turistëve, pasi ato përmbajnë vlera turistike, shkencore, kulturore e didaktike. Për vlerat e përmendura më sipër disa prej tyre kanë marrë edhe statusin e monumentit të natyrës me vendim të Këshillit të Ministrave. Lista e monumenteve të natyrës, tregon se në rrethin e Sarandës kemi një ofertë ekoturistike mjaft të pasur. Në ofertën ekoturistike bëjnë pjesë objektet e natyrës së gjallë e jo të gjallë.

Motivet biogjeografike janë pjesë e vlerësimit turistik me vlera të veçanta. Tërësitë ambientale të shumë mjediseve gjeografike varen nga mbulesa bimore kurse numri

i kafshëve sidomos të egra krijojnë kushte për zhvillimin e turizmit të gjuetisë. Ato paraqesin në forma sa të zakonshme aq dhe specifike të cilat vlerësohen si faktori me rëndësi në turizëm. Mbizotërojnë shkurret dushqet dhe shoqërimet tipike mesdhetare me zhvillim të hershëm e të vrullshëm në stinën e pranverës të cilat në saj të ngjyrave formave kanë vlera të mëdha dekorative dhe rekreative.

Sektori i transporteve është shumë i përgjithshëm dhe studimet marketing ndryshojnë sipas mënyrave dhe vendeve të ndryshme. Sipas mënyrave në të cilën realizohet transporti, ofrohen shumë llojë shërbimesh në këto elemente të produktit turistik. Karakteristikat e ndryshme të këtyre mënyrave e bejnë të veshtire përgjithësimin apo detajimin e marketingut të transportit. Produkti i transportit është i ndjeshëm ndaj ndryshimit të faktorëve të jashtëm, të cilët ndikojnë në cilësinë e produktit.

Saranda ndodhet 300 km larg Tiranës. përkohesisht mjete i vetem i udhëtimit për në Sarandë janë automjetet. Ka dy mënyra që mund të arrihet në Sarandë: Me rrugë tokësore dhe detare. Lidhja e saj me pjesë të tjera të Shqipërisë kalon në dy akse rrugore të rëndësishme: nga Vlora, udhëtimi bëhet përgjate Rivieres dhe nga Gjirokastra lidhet me Tepelënen, Fierin dhe Tiranën. Transporti detar i Sarandës e lidh qytetin me ishullin Grek të Korfuzit dhe në rrugë tokësore lidhe me Igumenicën. Me interes shihet ideja e ndërtimit të aeroportit në fshatin e Vrionit, 5 km larg Sarandës. Lehtësi për turistët në Sarandë ofron edhe shërbimi urban brenda qytetit.

Turizmi është një industri që karakterizohet nga përfshirja intensive e krahut të punës. Burimet njerëzore për këtë industri janë vlerësuar si 'lende e pare' apo janë parashikuar nga ekspertet si faktori me i rëndësishëm që do të përballohet nga kjo industri gjatë dekadave të fundit dhe në vazhdim.

Në Sarandë zhvillojnë aktivitet turistik 120 njësi hoteliere e të shërbimit me kapacitet akomodues 5 mijë shtretër. Afërsisht po kaq kapacitet turistik funksionojnë edhe në ambjentet familjare. Vit pas viti Sarandës po i shtohen pushuesit sepse hotelet që ofrojnë shërbimin e akomodimit gjithnjë e më shumë po marrin në konsideratë rëndësinë e elementit shërbim.

Shërbimet turistike ofrohen nga një personel i trajnuar dhe kualifikuar duke bërë që turistët të ndihen si në vendin e tyre. Pjesa më madhe e ndërmarrjeve të akomodimit kanë buxhet të kufizuar për promocion, që kryesisht përdoret për broshurat. Tashmë në Sarandë gjen hotele dhe restorante që ofrojnë shërbime cilësore dhe ndikojnë në formimin e imazhit të shërbimit në turizmin Shqiptar.

Por, ai që ka provuar dhe jeton eksperiencat e turistit apo klientit të këtyre shërbimeve vëren një karakteristikë të turizmit si ndërtime luksi, por që në mjaft raste mbesin të akullta, nuk mbushen me gjallërinë dhe ngrohtësinë e mikpritjes, duke humbur luksin dhe elegancën për shkak të shërbimit që ofrohet. Tipat më të rëndësishme të strukturave të akomodimit në Sarandë janë: Hotel Butriti, Grand-Hotel, Mediterane, Lindi, Lukova Palasa, etj.

Emrat e lokaleve që ofrojnë shërbime për vizitorët e Sarandës shprehin qartësisht edhe historinë. “Onhezmus” emri më i vjetër i Sarandës, “Butrinti”, “Dyzet Shenjtorët”, “Porto Eda”, emri i qytetit në përkujtim të vajzës së Musolinit gjatë periudhës së pushtimit fashist. Kjo periudhë kujtohet si periudha e konturimit të Sarandës moderne. Labëria, Çamëria, “Hasan Tasini”, “Baba Rexhepi” e të tjera janë emra që mbartin një pjesë të historisë dhe legjendave të shumta të kësaj zonë, me një dinamikë të paparë historike. Të gjitha këto ndodhen në një hapësirë që mund të arrihet edhe duke udhëtuar në këmbë.

Pasuritë arkeologjike të Sarandës kulmojnë me Butrintin e famshëm. Këtu mund të shohësh, të prekësh e të ndjesh historinë disamijëvjeçare të ruajtur të paprekur nga vitet. Është i vetmi vend në rajon ku janë pranë e pranë një kishë e një xhami dhe një sinagogë, një sintezë historike jo vetëm e qytetërimit të lashtë, por edhe të tolerancës fetare që karakterizon qytetin dhe gjithë Shqipërinë. Kalaja e Lëkurësit është jo vetëm një simbol arkeologjik dhe i rezistencës për identitet kombëtar, por edhe një shprehje e shenjtërisë së qytetit.

Për arsye të heterogjenitetit në kohë dhe stilit artistik objektet dhe monumentet kulturore historike zënë një vend të rëndësishëm në konsumin turistik të zonës. Aktivitet më të madh kanë monumentet arkitekturale urbane figurative dhe dekorative të cilat prezantojnë dhe historinë e pasurinë kulturore të një treve. Vlerësimi turistik është i lidhur dhe me aspektin e ruajtjes së fondit të tyre

resaturimet dhe prezantimin e marketingun në publikun e gjerë. Kjo zonë është e pasur me objekte që i përkasin periudhës së paleolitit asaj antike, mesjetës e deri ditëve tona.

Aq e lashtë sa është historia po aq e lashtë është edhe kultura e kësaj zonë. Krahas atyre të zbuluara edhe nëntoka përmban një numër të madh monumentesh të epokave të ndryshme historike që përbëjnë thesar të kulturës së saj.

Qendra më e rëndësishme antike e zonës është Butrinti i cili pozicionohet 16 km në jug të Sarandës mbi një kodër të gadishullit të Ksamilit buzë liqenit me të njëjtin emër dhe më një shtrirje prej 4- 5 ha. Kjo qendër ka vlera të jashtëzakonshme ndaj dhe për rëndësinë që ka është bërë pjesë e trashëgimisë botërore nga UNESCO. Ka dhe një mori zbulimesh të tjera arkeologjike.

Vlerësimi turistik i këtyre motiveve nënkupton kulturën shpirtërore materiale dhe origjinale. Elementë të tillë si, veshja, këngët e vallet, instrumentat muzikorë, doket dhe kalonët, fjalët e urta, legjendat, feja, institucionet e saj përbëjnë vlera atraktive të cilat shfaqen në përmbajtjen dhe mënyrën e prezantimit të tyre. Turizmi fetar është lloji më i vjetër në botë i turizmit dhe në këtë zonë bashkëjetojnë më së miri mysliman ortodoks dhe bektashinj me objektet e tyre të kultit dhe adetet e festat e tyre tipike.

Zona trashëgon dhe kultivon në gjirin e vet një thesar të pasur e të bukur folklorik ku pasqyrohet vitaliteti kultura materiale e shpirtërore dhe ndjenja fisnike. Është e vërtetë që orenditë sendet dhe veshjet tradicionale janë hequr nga përdorimi i përditshëm por, ato gjenden në muze dhe demonstrohen në saj të manifestimeve folklorike, ditëve festive etj. Turizmi bëhet faktor aktiv për prezantimin e tyre. Në zonë dallohen rreth 20 llojë kostumesh të përshtatura sipas moshës dhe gjinisë ku dallojnë fustanellat dhe dizenjot e veshjeve me ornamente tipike si shqiponja gjethe zogj etj. si dhe pa harruar larminë e ngjyrave.

Elementi më atraktiv për turistët sidomos ato të huaj krahas potencialit natyror janë edhe monumentet kulturore. Ato nisin nga monumenti që i ka dhënë emrin Sarandës, ai i 40 Shenjtorëve, ku janë duke u bërë sistemimet e fundit, ndërkohë që përballë saj, gjendet Kalaja e Lëkurësit, që Sarandën e sheh si nga bordi i një

avioni. Muzeu “Onhezmi-Kaonia”. ajo është e shtruar me një dysHEME prej mozaiku origjinali, që është quajtur si “bizhuja arkeologjike” e Sarandës.

Vetëm gjysmë kilometri më në qendër të qytetit të Sarandës, gjendet Sinagoga Hebraike që ka Saranda, si simbol të pranimit dhe bashkëjetesës së kulturave mes kristianizmit shqiptar në bazilikën e shekullit të gjashtë dhe sinagogës hebraike. Në Sarandë ndodhet Sinagoga më e vjetër e Ballkanit, nga një koloni hebraike e vendosur rreth shekullit të tretë të erës sonë, shumë më herët se në të gjitha pjesët e tjera të gadishullit. Tani mbi tokë ndodhet vetëm një pjesë e Sinagogës, e shtrirë në të majtë të qendrës së qytetit dhe e mbuluar nga rëra, në mënyrë që të mos pësojë gjë nga erozioni.

I shtrirë mes blusë së detit, me një breg krejtësisht shkëmbor, rrethohet nga një uje i paster, i thelle dhe nga një gjelberim i jashtezakonshem. Era e freskët e plazhit që të shoqëron përgjatë gjithë rrugës të jep mundësinë të shijosh pushimet, ende pa shkuar në destinacion. Duke shijuar rrugët përgjatë bregdetit, të bie në sy një bukuri e rallë e natyrës.

Teksa shkon në skajin më jugor të Shqipërisë nga ana bregdetare në Sarandë, sheh një gjallëri tjetër, ku këtë kjo mrekulli shijohet nga shumë turistë. Rruga nga Riviera dhe pamja e saj ka mahnitur pa masë të gjithë vizitorët për herë të parë. Në Sarandë turistët e huaj kanë preferuar të shohin dhe manastiret e shumta. Në Sarandë ndodhet Sinagoga më e vjetër e Ballkanit, nga një koloni hebraike e vendosur rreth shekullit të tretë të erës sonë, shumë më herët se në të gjitha pjesët e tjera të gadishullit. Tani mbi tokë ndodhet vetëm një pjesë e Sinagogës, e shtrirë në të majtë të qendrës së qytetit dhe e mbuluar nga rëra, në mënyrë që të mos pësojë gjë nga erozioni.

Mozaiket janë zbuluar në pika të ndryshme të qytetit të Onhezmit dhe deshmojnë për shkallen e zhvillimit e të lulezimit të qytetit në shekullin. II-III pas krishtit. këto mozaik ndodhen brenda murit rrethues të keshtjelles, përball kinoteatrit, gjendet dysHEMEJA e një kishe bazilike e cila është e shtruar me mozaik të zbukuruar e ornamente me ngjyra. Mozaiku rrethohet me murë të trash rreth 60 cm me lartesi deri në 30 cm. në qender të mozaikut me motive gjeometrike rrethore është vizatuar figura e një delfini në pozicion zhytjeje.

Gjeografia turistike e Sarandës, ofron mrekullin e asaj që të sjell natyra dhe puna e njeriut. Nese vitë me pare, harta e vendeve të pushimit e grupuar në ato që munde qytete të pushimeve, tani kjo hartografi është rritur si në përmase, ashtu edhe në cilësi. në cilësin e shërbimit, akomodimit, e elementeve të tjere të turizmit.

Saranda luan një rol të rëndësishëm edhe në fushen e artit. Çdo vit në Butrint, në teatrin antik zhvillohet gjatë veres Festivali ndërkombetar i Teatrove, i cili mbledh me dhjetra trupa të njohur teotrore. Dikur aty luante kori dhe aktoret e tragjedisë se Eskilit dhe Euripidit sot luajnë aktore dhe aktore nga e gjithë bota. Saranda ka qenë e preferuar nga të gjithë kineastetshqiptare të cilët kanë xhiruar një pjesë të filmave ketu. gjatë sezonit turistik dhe në fundjave restorantet dhe tavernat, ofrojnë muzik live, ku kendohen nga kengetaret e njohur të Shqipërise.

Në Sarandë flitet nen dialektin jugor i Toskeris, njeri prej dy dialekteve të gjuhes Shqipë. Nga pikpamja etnografike Saranda ndodhet në dy zona: Laberi dhe Cameri të cilat kanë përbashkëta dhe të veçantat e tyre në zakone, rite, folklore, veshje, artizanat, etj. Krahas ndërtimeve fetare si manastiret, xhamitë, kishat ose ndërtimeve historike të antikitetit, mesjetës, në të gjithë territorin e Sarandës ndodhen shtëpi të ndërtuara me gurë.

Potenciali demografik ka një rëndësi shumë të madhe sepse me faktorin njeri lidhet drejtpërdrejt zhvillimi i turizmit. Madje popullsia luan rol të dyfishtë: së pari si pjesë e ofertës turistike që tregton vendin e vet dhe së dyti sepse edhe ajo vetë shndërrohet në konsumatore. Zhvillimi i turizmit në Sarandë ka sjellë impakt të mënjëhershëm në rritjen demografike të popullsisë në mënyrë të veçantë pas viteve 1960 ku lëvizja turistike fillon të rritet ndjeshëm.

Oferta turistike e qyteteve përbën një bazë të mirë për konsumin turistik. Veçanërisht qëndrat urbane janë ato që paraqesin një aktivitet të veçantë turistik. Nga njëra anë këto hapësira paraqiten si qëndrat më të mëdha nga ku dalin turistët dhe nga ana tjetër ato prezantohen si hapësira ku zhvillohen qarkullimet më të mëdha turistike. Saranda ka njohur një traditë të zhvillimit të turizmit. Ky qytet ka një farë infrastrukturë turistike dhe bazë materiale turistike më të përshtatshme e cila mund t'iu përgjigjet formave dhe llojëve të ndryshme të qarkullimit turistik.



Nga analiza e ofertës turistike dhe të mundësive të qytetit dallojmë këto forma të qarkullimit turistik:

- ✚ Lëvizje turistike rekreative për pushime bredetare
- ✚ Vizitat turistike, të cilat mund të jenë një ditore ose disa ditore, në grupe ose individuale.
- ✚ Lëvizja turistike tranzite, që karakterizohet nga vizitorë që kalojnë përmes Sarandës për në brigjet e Greqisë.
- ✚ Lëvizje për qëllime profesionale e biznesi.
- ✚ Lëvizje turistike për qëllime kulturore.

Tashmë Saranda është përfshirë në një qarkullim të turizmit masiv klimatiko balnear e të peisazhit. Kjo është lëvizje stinore e cila kryhet në grup, familjare etj. Ka edhe lëvizje të tjera turistike por janë të vogla në raste sporadike dhe nuk kanë krijuar një traditë të mirë në zhvillimin e tyre siç janë ato të panairëve, prezantimeve, ekspozitave dhe eksperiencave turistike.

Operatorët turistik kërkojnë t'i bejnë një shpjegim të arsyeshëm rritjes së numrit të turistëve drejt vendit tonë. Sipas tyre, jo gjithçka lidhet me spotet publicitare në televizionet ndërkombetare edhe pse ato e kanë krijuar një lloj efekti. Rritja është shumë graduale prandaj vit pas viti ka një rritje të dukshme të flukseve turistike. Kjo ndodh edhe nga kostoja e pushimeve, sepse të pushosh në vende të tjera që janë konkurrencte me Sarandën, përta i përket pozitës gjeografike dhe pasurive natyrore, kushton më shumë.

Saranda është një vend i bekuar nga zoti, ku njerëzit, natyra dhe historia janë pasuria e tij më e madhe. Duke u ndërthurur bukur dhe harmonishëm antikiteti me modernen, ngrohtësia diellore me atë njerëzore dhe shpirtërore, Saranda po karakterizohet përherë e më shumë nga zhvillimi intensiv e me risi konkurruese në tregun rajonal e më gjerë. Ajo është pozicionuar aktualisht në pikën relativisht më të lartë të hierarkisë turistike të vendit.

Origjina e turistëve është e ndryshme. Maqedonia, Kosova e më pak Mali i Zi janë vendet kryesore nga nisen turistët që duan të kalojnë pushimet në Sarandë. Ndërsa për të vizituar pikat kulturore dhe arkeologjike në vend më shumë të interesuar janë italianët, gjermanët, anglezët, serbët dhe grekët. Ndër turistët e Europës Veriperëndimore janë gjermanët, anglezët, italianët, holandezët dhe grekët, që kryesisht e vizitojnë Sarandën, në mënyrë individuale. Ndërsa nga Europa Qendrore shihet një interesim i dukshëm nga çekët, polakët e sllovenët. Nuk duhet harruar interesimi i turistëve amerikanë, kanadezë, etj. Në bazë të qëllimit të vizitës së turistëve në Sarandë, zgjat edhe periudha e qëndrimit. Për ata që frekuentojnë plazhet nga një javë deri në 15 ditë, kurse për turistët kulturorë, ditët maksimale mund të numërohen vetëm deri në 7.

## **1. 2. PRODUKTET TURISTIKE QË OFRON SARANDA**

Produkti turistik është një produkt me natyrë të veçantë, fleksibl që rrjedh nga bashkëekzistenca në të e elementeve të ndryshëm të cilët, të lidhur me njeri-tjetrin japin një produkt të vetëm. Produkti turistik, është një përmbledhje e të mirave materiale dhe e shërbimeve, që plotësojnë kërkesën e turistëve gjatë udhëtimit dhe qëndrimit të tyre për një kohë të caktuar larg venbanimit të përhershëm. Ky produkt është gjithnjë "i papërfunduar" në dallim nga produktet e tjera sepse ky i nënshtrohet një plotësimi nga ana e konsumatorit duke shtuar shërbime të tjera.

Konsumatorët turistë që nga momenti kur merr vendimin që të kalojë kohën e lirë në mënyrë turistike dhe deri në momentin e plotësimit të nevojave turistike e formojnë vetë produktin turistik. i parë nga ana e turistëve produkti turistik përcaktohet nga nevojat turistike, pra ai përfshin të mira materiale dhe shërbime të ndryshme në funksion të plotësimit të nevojave turistike të blerësve. Për konsumatorin ky produkt është një "produkt global". Komponentët përbërës të këtij produktit janë:

- ✚ Shërbime të lidhura ngushtë me veprimtarinë që karakterizon ndërmarrjen;
- ✚ Shërbime të lidhura, por që mundet të ndryshohen nga prania e pavarur e operatorëve të tjerë në treg;

✚ Shërbime të ofruara nga kategori të tjera ndërmarrjesh;

✚ Infrastruktura e mjedisit ku vepron ndërmarrja (transporti, kultura, argëtimi, etj)

Nisur nga potenciali natyror që zotëron Saranda ofron disa forma të turizmit, të karakterizuara nga motive të ndryshme, por produkti më kryesor është ai mbi motivin “pushim”. Produktet turistike që ofron Saranda janë: **turizmi i diellit dhe i plazhit dhe turizmi i interesit të veçantë.**

### **TURIZMI I DIELLIT DHE I PLAZHIT**

Saranda është pozicionuar në tregun vendas dhe atij ndërkombëtar si një destinacion pushimi. Bërthama e këtij produkti janë përfitimet që marrin pushuesit nga shfrytëzimi i të mirave turistike që posedon Saranda si detin e pastër dhe të kaltër, bregdetin tërheqës, klimën mesdhetare dhe numrin e madh të ditëve me diell. Ky produkt i ofruar nga Saranda si destinacion turistik plotëson nevojën për pushim dhe rekreacion të turistëve. Por krahas këtyre elementeve Saranda ofron edhe një disa shërbime që e rrisin forcën konkurruese të këtij destinacioni në tregun turistik. Këtu mund të përmendim qytetin e Butrintit, shumë monumente kulturore në qytet, afërsinë e Syrit të Kaltër, të qytetit të Gjirokastrës, të ishullit Grek të Korfuzit etj. Këto elemente ofrojnë shërbime që plotësojnë produktin “pushime” të ofruar nga Saranda dhe e diferencojnë këtë produkt në tregun turistik. Kërkesa për këtë produkt vjen kryesisht nga turistë vendas dhe turistë nga Kosova dhe Maqedonia.

Plazhet bregdetare janë ato që mbizoterojnë natyrën e hapësirës bregdetare jonike të Sarandës. Ky bregdet, që shpeshherë emërtohet edhe Riviera e Sarandës dallohet për një vijë bregdetare të lartë shkëmbore, por që thuhet nga disa kepa e plazhe zallore shumë të bukur ndër të cilët mund të përmenden plazhi i Borshit etj.

Përgjatë vijës bregdetare, në veri dhe në jug të qytetit të Sarandës ka pak sektorë të përshtatshëm për banjo uji dhe dielli. Plazhet me rërë këtu janë të pakta dhe zëvendësohen me të ashtuquajtura pllaka, sipërfaqe të sheshta, të valëzuara ku pushuesit shtrihen për banjo diellore. Sektorët më të përshtatshëm të pllakave janë

në krahun e djathtë të rrugës automobilistike Sarandë-Butrint (sektori Sarandë-Çukë), por sektori në veri të qytetit të Sarandës nga Porti deri në Gjirin e Limionit përfaqëson vendin e mirëfilltë të quajtur Pllakat e Sarandë.

Me një gjatësi të përgjithshme të vijës bregdetare prej 66, 7 kilometrash, që laget nga deti Jon, me një pozitë të favorshme gjeografike dhe dalja e gjerë në detin Jon e Mesdhe, afërsia me ishujt Jonianë si një nga pikat më të frekuentuara turistike, bukuritë e relievit dhe pasuritë e shumta historike e kulturore, e bëjnë Sarandën tepër të favorizuar për zhvillimin e turizmit në raport me rajonet e tjera të vendit tonë. Janë dhjetëra plazhe me ujëra të kulluar që zgjaten përgjatë gjithë qytetit. Pranë të gjitha plazheve nuk mungojnë baret dhe restorantet e shumta. Përgjatë vijës bregdetare, në veri dhe në jug të qytetit të Sarandës ka pak sektorë të përshtatshëm për banjë uji dhe dielli. Një vend i rrallë, që ofron një bukuri mahnitëse është edhe Gjiri i Kakomesë. Plazhi i virgjër me ujë të kulluar, rrethuar nga kurora e gjelbërë bën edhe më të veçantë këtë vend. Pranë këtij plazhi ndodhet dhe Krorëza, plazh tipik ranor me ujë të pastër, si dhe një Manastir, mjaft interesant për tu vizituar.

### **TURIZMI I INTERESIT TË VEÇANTË**

Saranda është një vend shumë i bukur. Saranda është një nga vendet që dallohet për bukuritë e veta natyrore, por edhe shumë burime turistike të ndërtuara nga dora e njeriut. Ajo është një nga qendrat e turizmit më të zhvilluara në Shqipëri. Ndër asetet e shumta turistike, objektet e trashëgimisë kulturore historike po marrin gjithnjë e më tepër vlerësimin e duhur. Saranda dhe rajoni përreth zotëron 120 monumente kulturore, të cilat u përkasin periudhave të ndryshme historike, që nga antikiteti i hershëm e deri në mesjetën e vonë. Përveç Butrintit, që ka status të veçantë si pjesë e pasurisë botërore të UNESCO-s dhe mjaft i eksploruar e i vizituar, vende të tjera arkeologjike e objekte të veçantë po kthehen në vende pelegrinazhi e destinacione turistike.

Në vëmendje të veçantë të MTKRS dhe organeve vendore të pushtetit janë parku i Finiqit, kompleksi i Onhezmit, Manastiri i Mesopotamit, Manastiri i 40 Shenjtorëve, Xhamia e Rusanit etj. Janë disa projekte për restaurimin dhe rehabilitimin e territorit të tyre. Brenda territorit të bashkisë së Sarandës objektet

më përfaqësuse, ku po ndërhyhet për vlerësimin dhe jetëzimin e tyre, janë sinagoga-bazilika e Onhezmit dhe Manastiri i 40 Shenjtorëve. Monumenet antike në Sarandë:

- ✚ Qyteti antike i Butrintit
- ✚ Syri i Kalter
- ✚ Kalaja e Lekursit
- ✚ Gjiri i kakomes
- ✚ Manastiri Onhezmi-Kaonia
- ✚ Manastiri i 40 shenjtove
- ✚ Manastiri i Mesopotamit

**Qyteti antik i Butrintit:** Nje qytet që ndodhet 18 km larg nga qyteti që daton në shekullin VII-VI para krishtit i mbrojtur nga UNESCO që nga viti 1992 si një nga vendet e trashëgimisë kulturore. Qyteti që spikat objekte me rëndësi të veçante, si Teatri i baptisterit, Kompleksi i ndërtimeve të periudhës mesjetare, prej vitesh ka zgjuar dhe vazhdon të zgjoj interesimin e arkeologëve dhe të turistëve të shumtë vendas dhe të huaj. Ky qytet është i quajtur, një qytet që të bën të harrohesh në mendime romantike, i vetmuar në mes të rrenojave të një qyteti madhështor të quajtur Butrint. Pas mbërritjes në Sarandë, një ngushticë piktoreske me pamje nga deti dhe moçalet ju drejtojnë në këtë qytet ndërmjet një pejsazhi me ullinj dhe plantacione agrumesh. Butrinti i cili u shpall nga UNESCO si qytet i pasurisë botërore, fillimisht banohej nga Ilirët dhe e mori emrin plagët e Buthrotos i cili u sakrifikua nga princi “Aeneos i Trojës” që të kishte një hyrje të sigurt në tempullin Dodona në Epir.

Si shumë qendra të tjera të rëndësishme arkeologjike në Shqipëri dhe Butrinti u shpall monument kulture që në vitin 1948 në një akt të parë rregullues për monumentet e kulturës. Parku kombëtar i Butrintit u krijua nga Ministria e Kulturës. Kufijtë e këtij parku shtrihen në daljen e fshatrave përreth tij si: Ksamili, Vrina, Shendellia dhe Xarra. Ky park u bë një domosdoshmëri për ruajtjen e vendodhjeve dhe atmosferës unike të Butrintit, për ruajtjen e të dhënave arkeologjike të disa qendrave dhe monumenteve të zbuluara në këtë vatër të qytetërimit antik. Objektet më të rëndësishme në muzeun e Butrintit janë ”**koka e Deas**”, dhe dy shtatoret e dy përendive. **Artemisa**, kjo statujë e përandorisë

femërore paraqitet në lëvizje. E punuar me material mermeri dhe teknikë gdhëndjeje. **Apolloni** koka i është punuar me vetë dhe ndodhet në muzeun e Butrintit. Kemi objekte të tjera si: **Portreti i Herkulianës** dhe **Potret Vajze** etj. **Teatri i Baptisteris**, i cili është monumenti më i rëndësishëm i periudhës paleokristiane. Salla e pagëzimit në formë rrethore me diametër 13. 50m është shtruar me mozaikë shumëngjyrësh, me motive nga bota shtazore e figura gjeometrike, të cilat kanë vlerë të veçantë artistike. Salla përshkohet nga dy rradhë kollonash granitë mbi të cilat kanë qenë mbështetur qemerët e çatit.

## DIAPORITI

Ndodhet buzë Liqenit të Butrintit, në verilindje të tij, vendosur mbi një pllajë në formë taracash me amplitudë që luhetet nga 0 - 25 cm, me një sipërfaqe disa hektarësh. Vendosija e këtij vendbanimi në një areal gjeostrategjik me rëndësi për zonën, me sa duket lidhet me vetë emrin e tij me origjinë nga gjuha e vjetër greke, që do të thotë vend ku kalojnë dy rrugë. Fazat kryesore të këtij vendbanimi, nisin me periudhën republikane të zbuluar nga gërmimet në vilën romake, e cila prezantohet nga ndërtimit i disa mureve, si dhe nga qeramika helenistike e vonë dhe ajo republikane. Me interes është zbulimi i afreskut në një ndër kthinat e banesave në qendër të vendbanimit.



**Pylli i Butrintit.** Inkuadrohet në Parkun Kombëtar të Butrintit së bashku me qytetin antik të tij (Buthrot). Ka një sipërfaqe prej 15 ha dhe ndodhet në lartësitë 30-50 metra mbi nivelin e detit. Përfaqëson një relik të florës së pasur mesdhetare. Është i shumëllojshëm i dendur, gati i pakalueshëm që i ngjan një xhungle të vërtetë. Në përbërjen e tij gjenden lloje me gjelbërim të përhershëm si: dafina, fishekarthi, kullastra, mimoza si dhe lloje gjetherënës, frashëri (*fraxinus angustifolia*), bliri, shelgu, vidhi, lofata etj. Drurët arrijnë lartësi deri 12 metra, kanë diametër 60 - 80 cm dhe arrijnë moshë maksimale 200-vjeçare.

**Syri i kaltër.** *Një herë e një kohë, fryu një erë kaq e fortë, sa tundi detin nga fundi dhe deti nxori një gjarpër.. . Ra një re dhe gjarpri e hodhi në malin e Sopotit.. . Gjarpri gjigant hante kafshët e njerëzit dhe të mbjellat i prishte.. . U ngrit një plak, ngarkoi një gomar me thasë me eshkë dhe vajti afër lubisë e i vuri zjarrin eshkës. Kur gjarpri hëngri gomarin, zjarri i eshkës përbrenda e dogj. Bisha briti, 'Ku je ti det, që më bërë kokën dhe ti lumë, vëllai im.. . !'. E u shtri për vdekje. U nis deti nga Vivari dhe lumi nga Sopoti, por s'e proftasën dot. Në agoninë e ngordhjes gjarpri përplaste bishtin në faqen e malit, ku mbetën shenjat që duken. që nga ajo kohë deti me malin janë të lidhur me njëri-tjetrin si baba e bir".*

Syri i Kaltër, monument natyror, një nga burimet më të rralla në botë, i cili mahnit me bukurinë e tij këdo që e viziton. Ndodhet vetëm 15 kilometra larg Sarandës dhe pret çdo ditë shumë vizitorë nga të gjitha vendet e botës. Syri i Kaltër është një nga bukuritë e mëdha që natyra i ka falur tokës. Tashmë është bërë traditë udhëtimi në pikën turistike, e pagëzuar nga një inxhinier. Syri i Kaltër, është një pikë shumë e bukur që ndodhet vetëm 2 km në të majtë të rrugës Sarandë-Gjirokastër.

Ky burim i kaltër me origjinë karstike filtron ujrat e pellgut ujëmbledhës të Malit të Gjerë dhe Fushës së Dropullit, për të nxjerrë në sipërfaqe ujin e kristaltë. Bukuritë mahnitëse të kësaj perle të natyrës shtohen për shkak të rrethimit nga gjelbërimi i rrallë që natyra e ka falur pa kursim. Nga thellësia e tunelit, përmes të cilit uji del në sipërfaqe, burimi merr ngjyrën blu, që i ngjan bebes së syrit. Po sa fillon rrjedhën, ngjyra fillon e çelet drejt se kaltrës. Bimësia që rrethon Syrin e Kalter në pjesën e sipërme të tij i ngjan shumë qerpikve, ndaj me të drejtë është quajtur "Syri i Kaltër". Ai është burimi më i madh ndër 18 burimet që shpërthejnë rrëzë Malit të Gjerë dhe gëzon statusin e monumentit të natyrës. Thellësia e tij është tepër e

madhe, arrin deri në 45 metra. Sipas të dhënave zyrtare, numri i vizitorëve të huaj në këtë pikë turistike shkon në dhjetra mijë në vit, të ardhur nga Anglia, Danimarka, Holanda, Franca, Italia, vendet nordike, brigjet e Mesdheut, amerikanët, aziatikët, australianët e deri nga Brazili.

**Kalaja e Lekursit.** Mendohet nga historiant të jet ndërtuar rreth viteve 1537, në kohën kur Sulltan Sulejmani sulmoi Korfuzin dhe i lindi si domosdoshmeri kontrolli i Skelës së Sarandës dhe i rrugës Sarandë-Butrint. Kalaja ndodhet midis rrënojave të fshatit Lëkurës mbi majën e një kodre të lartë që ngrihet sipër qytetit të Sarandës. Ka një pozicion të veçantë strategjik nga ku mund të shikoni gjithë qytetin e Sarandës dhe rrugën që shkon në Butrint, gjithashtu mund të shijoni dhe një panoramë të ishujve të Ksamilit. Ka formë katrore me dy kulla të rrumbullakëta. Sot në Lëkurës funksionon një restorant me arkitekturë të hershme dhe tepër bashkëkohore. Është kthyer në një nga pikat më të bukura turistike dhe nga më të frekuentuarat për çdo turist që viziton Sarandën.

Pranë qytezës së Ksamilit gjenden katër ishuj me një sipërfaqe rreth 9 ha. Ishujt janë të veshur me bimë e shkurre me gjelbërim të përhershëm. Në ishujt shkëmborë të Ksamilit gjenden dhe plazhet më të bukura në gjithë Rivierën. Dallohen për natyrën e tyre ekzotike me ujra të pastër kristal dhe gurë të vegjël. Ishujt e Ksamilit janë shumë të frekuentuar për sezonin e verës nga pushues të shumtë venda dhe të huaj. Kohët e fundit janë ngritur edhe lokale një mundësi më shumë për të kaluar puashimet në Sarandë. Për të mbërritur është shumë e thjeshtë funksionojnë shumë agjenci më anije dhe skafe private të cilët kryejnë sistematikisht lëvizjen e turistëve në vajtje dhe ardhje me çmime shumë të arsyshme.

**Rrapi i Nivicës.** Pasi ke përshkruar afërsisht 10 km rrugë kombëtare Sarandë - Vlorë, në drejtim të rrugës së bregdetit, në qendër të fshatit Nivicë, 500 metra larg rrugës nacionale, lartësohet një rrap madhështor me moshë 250 - 300 vjeçare. Rrapi është i shëndetshëm me kurorë të dendur dhe formon një hije të rëndë, tërheqëse për vizitorët. Vendi përreth tij, jo vetëm përreth trungut, por edhe përreth kurorës është shtruar e sistemuar me mure në formë stolash dhe i çimentuar. Vendndodhja e tij është e ngritur si ballkon mbi fushën e Delvinës me sheshpamje çlodhëse, freskuese e argëtuese. Është vendi më i preferuar në zonë. 18 metra i lartë rrapit ka një diametër kurorë rreth 19 metra dhe diametër mesatar të trungut



1,3 metra. Objekti ka vlera shkencore, estetike, historike, turistike e aktualisht është i ruajtur në gjendje të mirë.

**Rrapi i Shënvasisë.** Gjendet në qendër të fshatit me të njëjtin emër, në udhëkryqin që përbën sheshin kryesor të fshatit, ku kalon rruga nacionale gjatë bregut Sarandë - Vlorë. Në të kaluarën sheshi me rrapin 300-350 vjeçar përbënte vendin qendror të grumbullimeve të banorëve vendas, ku zhvilloheshin tubime e takime. Sot, sheshi përreth rrapit është sistemuar e rregulluar për t'i shërbyer vizitorëve. I lartë 15 metra, ai ka një diametër kurore 9,3 metra dhe diametri mesatar i trungut 2,5 metra. Ka vlera shkencore, biologjike, kulturore e edukative, estetike e historike. Objekti është përgjithësisht në gjendje të mirë dhe ka tharje natyrale të degëve.

**Kakome.** Kakomea është i pari gjë turistik në të majtë të rrugës, aty ku ujërat gjelbërohen nga faqet e veshura me drurë shekullorë të maleve që rrethojnë fushën e gjirit të vogël. Lisat dhe pemët e ullinjve në një lëndinë, të reshtuar me pyllin gjatë gjithë gjirit dhe në krah të djathtë një manastir mesjetar, ndërtuar në kodrën me gurë, i japin bukuri mahnitëse këtij vendi. Kisha trekëndëshe, ndodhet 1 km larg gjirit me të njëjtin emër të bregdetit Jon. Kisha hyn në grupin e kishave me tre absida të zhvilluara si në aspektin arkitektural ashtu dhe në ndërtimin struktural. Ngjason me ato të tipit kryq i brendashkruar me kupole mbi mbështetje të lira të periudhës përpara pushtimit osman.

Kisha i përmbahet tipit të manastirave duke patur në anën veriore dhe jugore dy abside. Muret e kishës janë ndërtuar në mënyrë të rregullt me gurë gëlqerore të pa punuar me tendenca horizontale lidhur me llaç gëlqeror. Në pjesën e sipërme përfundojnë me korniza guri prej dy radhesh. Çatia është e mbuluar me tjegulla, është dyjeshë duke patur me të ngritur pjesën që i takon kraheve jugore dhe veriore të kryqit që afron me bazilikat me kupole. Kisha është ndërtuar nga duar mjeshtrash, të cilët kanë punuar edhe në kishen e Krorezes. është e pikturuar në vitin 1672 nga piktori Mihal Jerma. Në Manastirin e Kakomesë festohet shenjtërimi i Shen Marisë.

Manastiri ka qënë një institucion ku përgatiteshin priftërinj për zonën përreth dhe ka pasur një bibliotekë të pasur kishtar. Përmendet ky manastir në veçanti për ungjillin kodik të shën Lukës, prej 300 faqesh, të shkruara në lëkurë. Mbi këtë

kodik popullsia e krahinës betohej me be, për zgjidhjen e padrejtësive të ndryshme. Manastiri i Kakomesë është ndërtuar në shek e XIV, përbehet nga konakët, muri rrethues dhe kisha e cila daton para pushtimit osman. Manastiri i Kakomesë, një nga tre manastiret e Triadhës së Shenjtë të ortodoksisë karakterizohet si një nga monumentet kulturore i kategorisë së parë. Besimtarët nga Manastiri i Kakomesë, vazhdojnë procesin e lutjeve në sheshin e kishës së dikurshme të shën Kozmait, e më pas ritin e larjen në ujin e Jonit, për larjen e mëkateve. Fëmijët janë të parët që zhyten në ujë, më pas të rriturit, ujërat fashitin disi dhimbjen që lë bregu i shkatërruar apo zhurrma e një motori uji që pasi ndalet afër jatit të bardhë me shumë shpejtësi i afrohet bregut ku lahen fëmijët.

**“Bizhuja” arkeologjike.** Muzeu arkeologjik “Onhezmi-Kaonia” në qender të Sarandës, është një pikë pelegrinazhi turistik të qytetit të Sarandës. “Nje bizhu e vërtetë në historikun e lashtë të ketij qyteti, nëpër të cilin kaluan të gjitha flukset e mëdha fetare dhe filozofike të kohërave”. Emertimi i tij “Onhezmi-Kaonia” shpreh pretendimet e kohrave antike, që nisin me shekullin 6-të, kur Saranda quhej Onhezmi. Këtij pretendimi i shtohet përfshirja e gjerë territoriale që sjell lënda arkeologjike e ekspozuar në këtë muze, e gjetur në territorin që njihet me emrin Kaoni.

Dyshemeja e muzeut është një tapet prej mozaiku. Ajo është një dysheme e shtruar me mozaik original, i cili në pjesën me të madhe të sipërfaqes i ka rezistuar kohrave. Zbulimi i një shtresë karboni pranë mozaikut original të dyshemesë së Muzeut Arkeologjik të Onhezmit flet për hirin e mbetur nga djegiet e qytetit të lashtë së bashku me skulpturat, monedhat, vazot, stolitë dhe dëshmitë e tjera. Muzeu “Onhezmi-Kaonia” është një rajon arkeologjik nga më të pasurit në vend. Ndryshe ky muze është cilësuar si një nga e 12 qytetet e Epirit.

**Manastiri i 40 shenjtoreve.** “Vendi i shenjtë i shoqëruar me një ngjarje të rëndësishme, me një vend martirizmi, apo me varrin e një shenjtori është një nga tiparet përkufizuese të antikitetit të vonë. Bazilika e 40 shenjtoreve me strukturën e saj tepër interesante, shërbente si një qendër e madhe pelegrinazhi në të cilën ndalohej nga rrugët adriatike, por edhe ato të ballkanike. Kisha e 40 shenjtoreve që ka qenë fillimisht e vogël është zgjeruar në periudhën justiniane, proporcionalisht me rritjen e devocionit, aty nga shekulli VI duke u kthyer në një manastir. në kohë

të Ugolinit bazilikat ruajnë madhështinë e Bazilikës Justiniane të 40 shenjtorëve. Ky e konsideroi manastirin si një nga kishat më madhështore që kish parë gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri. Manastiri i 40 shenjtorëve, si rezultat i fluksit të vazhdueshëm të pelegrinëve, u shnderua në qendrën kryesore të banuar aty pranë. Në këtë shekull u ndërtuan dhe bodrumet e faltores, një hapsirë unazore e përberë nga një korridor dhe 10 dhoma të burgosura në shkëmb e pa dritare. Një sistem hapjesh të brendëshme realizonte ajrimin e mjediseve të mbyllura ku nuk ndjehej i ftohti i dimrit dhe as vapa e verës. Ky ishte konteksti i flukseve fetare në një pjesë të Ballkanit kur lindi kulti i 40 Shenjtëve. Në fakt ky numër është me gjasë simbolik dhe nenvizon faktin se një grup i madh njerëzish, aq sa për të bërë një komunitet i janë nënshtruar një privacioni për shkak të ndërjegjjes

**Manastiri i Mesopotamit.** Ndodhet në pjesën jugore të fshatit Mesopotam, fare pranë Finiqit. Në fillim ka egzistuar një tempull pagan dhe mbi rrenojat e tij është ndërtuar Kisha e Shën Kollit, mendohet të jetë ndërtuar në kohën e perandorit bizantin Kostandin i IX Monomaku. Kisha e Shën Nikollit ka një arkitekturë tepër të veçantë të stilit bizantin. Nga manastiri ruhen rrënojat e mureve me një sipërfaqe rreth 100 m dhe kontrollohen nga 7 kulla drejtëkëndëshe. Muret rrethues janë më të hershëm sesa kisha që ekziston akoma. Dhomat e manastirit janë të ndërtuara më vonë. Kjo është një ndër kishat me të mëdha dhe më të vjetra të periudhës bizantine që ruan vlera të mëdha. Muret e jashtme janë të ndërtuar nga gurë gëlqerore të mëdhenj. Zbukurimet murale janë në forma të ndryshme, ku përmendim: një shqiponjë, dy dragoj dhe një luan në njerën anë ndërsa në anën tjetër ndodhet një kafshë mitologjike. Mozaiku i sallës i ruajtur akoma paraqet një dragua me krahë hapur. Kisha ka pasur dy rindërtime në vitet 1793 dhe 1845 këto rindërtime e kanë ndryshuar shumë pamjen e kishës dhe mendohet që të këtë humbur shumë vlera.

Trashëgimia kulturore që posedon Saranda provokon lëvizje turistike të interesit të veçantë. Këto të mira turistike ofrohen në tregun turistik si elemente periferike të produktit “pushim”, por edhe si produkte të turizmit kulturor të kërkuara kryesisht nga vizitorë një ditore të ardhur nga ishulli i Korfuzit.

## KREU II

### ZHVILLIMI I LEVIZJES TURISTIKE NË SARANDËS NDER VITE

Historia e qarkullimit dhe e lëvizjes turistike në Sarandë do të ndahet në disa etapa zhvillimi. Kështu do të bënim një ndarje në këto etapa: etapa e parë në vitet 1945-1960, etapa e dytë në vitet 1960-1990, etapa e tretë në vitet 1990-1996, etapa e katërt në vitet 1997-1999 dhe etapa e pestë pas viteve 2000 e deri në ditët aktuale. Numri i turistëve të ardhur në vite ka pasur lëkundje të ndryshme dhe kjo si shkak ka politikën e ndjekura gjatë viteve. Gjatë viteve 1946-1956 turistët e huaj kanë pasur si vend origjinë Gjermaninë Lindore apo edhe ndonjë shtet tjetër. Por, në periudhën 1956-1990 nuk kemi zhvillim të turizmit, si rezultat i sistemit dhe rrugës së cilës ndoqi vendi. Numri i turistëve të huaj ishte shumë i vogël pothuajse i papërfillshëm në raport me turistët vendas.

Përsa i takon qarkullimit turistik në këtë zonë nga të huajt në etapën e dytë ai ka qënë i ndikuar edhe nga pozicioni i Shqipërisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Me ndërprerjen e marrëdhënieve të tjera të ish Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të kampit socialist u vërejt një ulje e dukshme e turistëve të huaj deri sa arriti një numër konstant i tyre por, që tashmë vinin edhe nga Evropa përëndimore. Këta turistë që do të vinin nga viti 1960-1985 përbënin miq simpatizantë dhe grupe mbështetëse të ideologjisë së Shqipërisë. Në vitin 1987 në përmirësimin e marrëdhënieve me Greqinë vendoset linja e tragetit Korfuz-Sarandë, e cila do të sillte një shtim të numrit të turistëve të huaj sidomos të atyre grekë. Numri i turistëve të huaj në vitet 1980 arriti në rreth 30000 ku mbi 98% e tyre ishin nga vendet e Evropës përëndimore si Italia, Austria, R. F. Gj, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Zvicra etj.

Gjatë kësaj periudhe zhvillimin më të madh e mori turizmi i brendshëm familjar e në grup ku qarkullonin pothuajse rreth 60000 familjarë dhe punëtorë në vit. Turistët e huaj në vendin tonë vinin kryesisht në rrugë tokësore rreth 60%, në rrugë detare 27%, dhe në rrugë ajrore 13%. Pas viteve 1990 ndryshimi i politikave në këtë fushë imazhi që kishte krijuar dhe po krijonte vendi ynë ngjalli interes për shumë turistë. Një shembull i tillë është ardhja e 3000 turistëve nga Korfuzi me qëndrim njëditor. Pas këtij rasti filloi të shtohej numri i turistëve të huaj dhe të zgjerohet shpërhapja

gjeografike e origjinës së tyre duke kapërcyer edhe kufijtë e kontinentit europian. Kështu në vitet e para turistët ishin nga Greqia, Italia, Hollanda, Franca dhe Amerika. Trazirat e viti 1997 -1998, imazhi që krijoi Shqipëria dhe gjendja kaotike e saj do të ndikonin ndjeshëm duke e çuar në shifrën më të ulët të numrit të individëve të përfshirë në lëvizjen turistike si ata vendas edhe ata të huaj. Mbas viteve 2000 stabilizimi i situatës në vend sjell një rritje të numrit të turistëve të huaj dhe vendas. Aktualisht duke patur parasysh skemën e Butler për ciklet dhe fazat e zhvillimit të turizmit Saranda po përjeton fazën e tretë e cila dallohet për zhvillim dhe përmirësim të infrastrukturës turistike, rritjen e investimeve dhe kapitaleve vendase dhe të huaja.

## 2.1. ANALIZA E QARKULLIMIT TURISTIK NË SARANDË NË VITE

Numri i turistëve që kanë vizituar Sarandën pas vitit 1990 ka ardhur në rritje, por kjo deri në vitin 1996, ku shohim një ulje të menjëhershme të numrit të turistëve. Kjo lidhet me trazirat dhe situatën kaotike që përjetoi vendi ynë në këtë vit, e cila zgjati deri në vitin 1998. Pas vitit 1998 vjen në rritje të numrit të turistëve por me ritme më të ulëta krahasuar me vitet e para të '90.

### Pasqyra 1: Numri i turistëve në Sarandë vitet 1992-1999

Viti	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Turistë gjithsej	8275	6375	8700	5200	5400	110	270	3518

Burim: Ministria e Turizmit

Pas vitit 2002 lëvizja turistike njihet vetëm trendin e rritjes. Kështu nga viti 2004 deri në vitin 2009 numri i turistëve lëviz nga 50000 në 395130, pra afërsisht tetëfishim i numrit të turistëve. Për katër vitet 2006 deri në 2009 ka rritje të lartë vjetore ku çdo vitë shtohen afërsisht 100 000 turistë.

### Pasqyra 2: Numri i turistëve të përfshirë në lëvizjen turistike në Sarandë për vitet 2004-2009

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Turistë gjithsej	50000	90000	130000	200000	300000	395130

Burim: Zyra e Turizmit Bashkia Sarandë

Nga viti në vit numri i turistëve vjen duke u rritur siç do ta shohim edhe nga pasqyra nr. 3 që pasqyron ardhjet turistike në Sarandë për vitet 2009, 2010, 2011 dhe periudhën janar-tetor 2012-

**Pasqyra 3: Numri i turistëve të përfshirë në lëvizjen turistike në Sarandë për vitet 2009-2012**

Viti	2009	2010	2011	2012
Turistë gjithsej	395130	602384	469830	446400

**Burim: Zyra e Turizmit Bashkia Sarandë**

**2. 2 Turistë vendas dhe të huaj të përfshirë në lëvizjen turistike**

Nga viti në vit ky raport ka ndryshuar ndjeshëm, ka pësuar lëkundjet e veta por, tendenca ka qënë gjithnjë rritëse dhe kjo si shkak edhe i rritjes së numrit të përgjithshëm të turistëve. Rritja e stabilitetit në vend imazhi që po mundohet të krijojë Shqipëria për një situatë të qëndrueshme dhe përpjekja për të ndjekur një strategji zhvillimi të turizmit ka sjell impakt të drejtpërdrejtë në lëvizjen turistike.

**Pasqyra 4: Numri i turistëve vendas në Sarandë në vitet 1992-1999**

Viti	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Turistë vendas	75	5432	7000	4500	3800	20	150	3100

**Burim: Ministia e Turizmit**

**Pasqyra 5: Numri i turistëve vendas në Sarandë në vitet 2004-2009**

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Turistë vendas	30000	60000	94000	120000	170000	220000

**Burim: Zyra e turizmit Bashkia Sarandë**

Edhe numri i turistëve të huaj ka ardhur në rritje nga viti në vit. Vitet e para pas vitit 1990 kanë një numër të lartë turistësh, motivet e të cilëve lidhen drejtpërdrejt me imazhin e vendit tonë si një shtet i mbyllur i izoluar si shteti më tipik socilaist i cili tani po hynte në rrugën e demokratizimit. Gjatë këtyre viteve vihet re një rritje e shpërndarjes gjeografike të vendeve të origjinës së turistëve. Pas viteve 2000

Shqipëria dhe potenciali i saj turistik ka ngjallur interes për turistët, të cilët tashme janë përfshirë në qarkullimin turistik me një shtrirje gjeografike shumë më të madhe dhe në vitin 2009 turistët e ardhur ishin nga rreth 70 vende të botës.

**Pasqyra 6: Numri i turistëve të huaj në Sarandë, 1992-1999**

Viti	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Turistë të huaj	8200	943	1700	700	1600	90	120	418

**Burim: Ministria e Turizmit**

**Pasqyra 7: Numri i turistëve të huaj në Sarandë, 2004-2009**

Viti	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Turistë të huaj	20000	30000	36000	80000	130000	180000

**Burim: Zyra e Turizmit Bashkia Sarandë**

Një rol shumë të rëndësishëm për ardhjen e turistëve në Sarandë luan edhe porti i Sarandës nga i cili zbarkojnë anije apo kroçere të ndryshme të cilat vijnë kryesisht pas ndalesave që kanë bërë në Korfuz. Që pas hapjes së transportit detar të linjës Sarandë-Korfuz që në 1987 numri i turistëve që zbarkojnë nga kjo linjë është shumë i madh dhe po vjen në rritje.

Rritja e fluksit të turistëve nga viti në vit ka çuar edhe në domosdoshmërinë e zgjerimit të infrastrukturës turistike. Kështu infrastruktura turistike ka ardhur vazhdimisht duke u përmirësuar. Çdo vit në këtë zonë shtohet numri i hoteleve dhe resorteve të ndryshme për nga cilësia dhe kapaciteti i tyre. Aktualisht në Sarandë sipas statistikave më të fundit ushtrojnë aktivitetin e tyre 120 njësi hoteliere me kapacitet shtetërisht që shkon deri në 2450 shtretër. Kështu krahasuar me vitin 1999 ku numëroheshin vetëm rreth 350 shtretër deri në 2009 numri i tyre ka ardhur në rritje pra gati shtatëfishuar. Madje ka edhe disa burime të tjera të cilat japin një numër shtetërisht që shkon në 5000 por kjo lidhet edhe me informalitetin e zhvillimit të turizmit. Shumë pronarë shtëpish private lënë hapësira të shtëpive të tyre për turistët kryesisht ata familjar duke iu shmangur në këtë mënyrë taksave dhe detyrimeve që kanë kundërshtuar institucioneve. Hoteli i vetëm me 5 yje në zonë

është Hotel Butrinti i cili është i certifikuar, ndërsa hotelet e tjera janë me tre yje por janë të vetdeklaruar.

Gjatë viteve të fundit është shtuar ndjeshëm edhe numri i shtëpive të dyta të cilat sipas statistikave të vitit 2009 të marra në rrethin e Sarandës shkon deri në 5500 shtëpi. Këto shtëpi kanë për pronarë njerëz nga zona të ndryshme të vendit por jo vetëm kaq, kohët e fundit ka edhe kërkesa nga të huajt të cilët janë të gatshëm të paguajnë çmime të larta për të pasur një shtëpi në Sarandë. Përsa i përket bizneseve të vogla që i shërbejnë drejtpërdrejt konsumit turistik numri i tyre shkon në 1600. Për t'i shërbyer turistëve nga vende të ndryshme sigurisht duhet informacion dhe në Sarandë viteve të fundit këtë detyrë e ushtrojnë zyrat turistike të cilat janë dy.

Si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës turistike është rritur edhe kohëqëndrimi i turistëve qofshin ata të huaj apo vendas. Kështu një tregues është edhe frekuentimi i hoteleve dhe netëqëndrimi i tyre. Sipas statistikave të Ministrisë së Turizmit rezulton se frekuentimi i hoteleve për vitin 1999 nga turistët e huaj ishte 277 ndërsa netëqëndrimi ishte në 637 netë në total për këtë kategori turistësh çka do të thotë se nëse do të llogaritnim kohëqëndrimin mesatar për secilin turistë ai përlllogaritet dyditor. Ndërkohë që paraqitet më i lartë për turistë vendas kështu frekuentimi i hoteleve ishte nga 4128 persona ndërsa netëqëndrimi llogaritet në total për këtë kategori turistësh 8810 netë çka do të thotë se nëse do të përlllogaritnim një kohëqëndrim mesatar ai është mesatarisht treditor. Ndërsa vitet e fundit ka një rritje të netëqëndrimit qoftë nga të huajt por edhe nga turistët vendas. Kështu turistët e huaj kanë një kohëqëndrim mesatar treditor kurse tursitët vendas kanë kohëqëndrim mesatar njëjavor.

Hotelet frekuentohen maksimalisht pra në masën 100% gjatë pikut turistik që i përket periudhës kohore 20 korrik deri në 22 gusht. Ndërsa mesatarja e përgjithshme e frekuentimit nga korriku në shtator është në masën 80%. Netëqëndrimi ka ardhur në rritje nga viti në vit por sërish ka një defiçit nëse do të shpreheshim kështu përsa i përket numrit të turistëve në mënyrë të veçantë atyre të huaj në raport me kohëqëndrimin e tyre. Shumë prej turistëve të huaj në sarandë kalojnë thjesht si vizitorë si rezultat i kalimit të kroçerave të cilat përshkojnë rrugët mesdhetare detare dhe një nga ndalesat e tyre tani është Saranda.



### KREU III

#### PROBLEMATIKA E TURIZMIT NË SARANDË NË TË ARDHMEN

Nuk ndodh shpesh që të gjesh në të njëjtin vend vende arkeologjike shumë të lashta, të rrethuara nga një **det shumë i bukur**, ku banojnë **njerëz mikpritës** në një **klimë të jashtëzakonshme**. Kjo është Saranda, që shtrihet buzë **Detit Jon**, një **vend magjepsës plot histori dhe legjenda**. Falë klimës së saj të butë, ia vlen të vizitohet Saranda dhe Shqipëria e Jugut, hotelet mund të prenotohen në çdo periudhë të vitit. Por si e kanë zbuluar Sarandën si destinacion turistikë? Çfarë ofron Saranda për turistin e huaj dhe sa janë shpenzimet që ata bëjnë gjatë një dite, janë disa nga pyetjet e bëra nëpërmjet një pyetsori drejtuar disa turistëve gjatë një studimi që kemi bërë.

Arsyeja e këtij studimi është që të sigurohen të dhëna lidhur me kërkesat dhe sygjerimet që mund të kenë turistët gjatë qëndrimit të tyre në destinacionin e Sarandës me qëllim që të përmirësohet produkti në të ardhmen. Kështu, pyetjes se nga e kishin marrë informacionin për të vizituar Sarandën si destinacion turistik ata ju përgjigjën sipas grafikut të mëposhtëm ku **42%** e kishin marrë informacionin nëpërmjet internetit **33%** nga thashethemet mes miqve ose të afërmeve të tyre dhe **25%** nëpërmjet agjencive turistike.

Pyetjes pse zgjodhët Sarandën për të kaluar pushimet përgjigjet e të intervistuarve ishin: **25%** ishin këtu për të takuar të afërmit, **34%** e të intervistuarve vizitonin Sarandën për atraksonet, për tu argëtuar dhe për të njohur kulturën e këtij vendi pasi kishin lexuar shumë për Butrintin si një nga thesaret arkeologjike jo vetëm të shqiptarëve por të gjithë Mesdheut, ndërsa **41%** për të parë vijën bregdetare për tu njohur me traditën pasi është e veçantë dhe ndyshe nga vendet e tjera të Evropës njerëzit këtu janë shumë mikpritës dhe bujarë.

Pyetjes se ku do preferonin të akomodoreshin për tu ndjerë sa më mirë **75 %** ishin për akomodimin në hotele ndërsa **25 %** ishin për akomodimin nëpër shtëpi private dhe familje.

Pyetjes se me se do preferonin të leviznin për të vizituar qytetin turistët e intervistuar ju përgjigjen **67%** transportin publik dhe **33%** do preferonin makina me qira.

Për pyetjen se çfarë ushqimi do preferonin të hanin gjatë qëndrimit në qytet fast food apo gatimet tradicionale të zonës turistët u përgjigjën **75%** të tyre do preferonin gatimet tradicionale dhe **25%** fast food.

Nga përgjigjet e dhëna në pyetsor u mblodh informacion edhe për shpenzimet në euro që një turistë bën në ditë për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e tij **20 %** shpenzonin **10 €** në ditë këta ishin turistët tranzit të cilët qëndronin disa ore në qytet

**50 %** shpenzonin **25€** në ditë këta ishin turistët që do qëndronin një javë **20 %** shpenzonin **50 €** dhe **10 % 100€** në ditë, këta ishin turist që do qëndronin 3 deri në 4 ditë. Nga llogaritja del se të ardhurat në valut brenda nje dite nga turistët që në intervistuar janë **345 €**.

Të pyetur se përse i shpenzonin paratë e tyre turistët u përgjigjën se **58 %** të shpenzimeve janë për akomodimin, ushqimin si dhe për pije gjatë ditës, **15 %** janë për vizitat në vendet arkeologjike **14 %** janë për tu argëtuar gjatë mbrëmjes dhe **13 %** për të blerë suvenire me pamje nga Saranda, Butrinti ose simbole kombëtare shqiptare. Turistët e huajt kanë interes për të vizituar përveç Butrintit edhe pasuritë e tjera natyrore si Syrin e Kaltër ishujt e Ksamilit etj.

Pyetjes se çfarë do donin të ndryshonin shumica e të intervistuarve u përgjigjën se zhvillimi i turizmit duhet të bazohet kritere të qëndrueshme. Ai duhet të jetë i pranueshëm ekologjikisht dhe të intergrohet në të gjitha aspektet e mjedisit, nuk mjafton vetëm një det i pastër dhe një reliev i bukur, por duhet edhe një ambient i pastër ku mbeturinat të mos hidhen në tokë por të ketë sa më shumë kazane plerash dhe të punohet për edukimin qytetar të njerëzve. Gjëja e dytë që do donin të ndryshonin ishte edhe zbatimi i ligjit antiduhan në vendet publike. E pa tolerushme kjo, tha një prej turistve, më shumë se infrastruktura jo e mirë më tmerron fakti i

mbeturinave të hedhura në tokë dhe pirja e duhanit në vende publike, nëse do të kthehesha përsëri në Sarandë do doja ta gjeja përmirësime në këtë drejtim.

Të pyetur se a do ta vizitonin përsëri Sarandën në të ardhmen **82%** e tyre u përgjigjën **PO** ndërsa **18 % NDOSHTA**

Duke parë dhe vlerësimin e turistëve vemë re se Saranda po bëhet gjithnjë e më shumë destinacion i kërkuar nga turistët. Prurjet turistike janë nga 95 vende dhe përbëjnë 44% të numrit gjithsej. Kjo çon në domosdoshmërinë e faktit që detyra e e strukturave vendore të jetë bashkërendimi i punës me bizneset private, lidhur me identifikimin dhe organizimin e një sërë aktivitetesh kulturore, artistike e sportive kombëtare, rajonale e lokale, përmirësimin e kapaciteteve të infrastrukturës turistike si dhe rritjen e sipërfaqeve të plazheve publike dhe të sigurisë në to.

Rritja e fluksit turistik nga viti në vit, ku koeficienti mesatar për pesë vitet e fundit i shtimit të numrit të turistëve është 0.8 si dhe konstatimet e bëra nga turistët gjatë studimit i vendosin vendimmarrësit lokalë për zhvillimin e turizmit në destinacionin e Sarandës përpara disa sfidave.

Kështu zhvillimi i turizmit do të duhet të matet dhe të vlerësohet në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, lidhur me aftësinë e tij për të përmirësuar mirëqënien e shqiptarëve. Në këtë aspekt, ai duhet të jetë pjesë e strategjisë për arritjen e prioriteteve të zhvillimit, të tilla si angazhimet e vendit për synimet e zhvillimit të mëtejshëm.

Më shumë turistë nuk do të thotë më shumë zhvillim apo të ardhura për vendin tonë. Tipi i turizmit që një vend zgjedh për ta zhvilluar, përcaktohet kryesisht nga kontributi për begatinë e banorëve të tij.

Përfitimet e prekshme të dëshiruara nga një strategji e suksesshme turizmi do të jenë rritja e punësimit, të ardhura shtesë për ekonominë, infrastruktura e përmirësuar dhe rritje e të ardhurave nga taksat për të kontribuar në përmirësimin e kujdesit shëndetësor, arsimit dhe në zhvillime të tjera shoqërore.

Përfitime më pak të prekshme përfshijnë konfirmimin e kulturës dhe të traditave, mundësia për të mbajtur brezin e ri të interesuar për të qendruar në vend (apo për t'u kthyer) në qytetet e tyre dhe kontaktet e shkëmbimet me njerëz nga kultura të tjera

Turizmi posedon potencial të shkelqyer si një katalizator për rritje ekonomike dhe prandaj është një sektor kyç në nivelin makro-ekonomik. Industria është intensive në krijimin e fuqisë punëtore dhe një burim kryesor i të ardhurave. Ekzistojnë rezultate të rëndësishme lidhjeje me sektorët e tjerë si ndërtimin, transportin, furnizimet, bujqësinë, industrinë ushqimore dhe artizanatin.

Turizmi është dukuri me karakter demokratik. Ai shërben për njohjen e vendeve dhe të personave, kategorive të ndryshme shoqërore dhe kombeve të ndryshme. Ai shihet si tërësi e dukurive me karakter ekonomik, që rrjedhin nga ardhja e turistëve dhe nga qendrimi i tyre në lokalitetin turistik, duke iu kushtuar rëndësi vlerave materiale e kulturore që sjell turisti.

Me qëllim që të arrihen objektivat dhe të realizohet aplikimi i strategjive të nevojshme është e nevojshme të plotësohen disa kushte.

Kështu parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit të pranohen në të gjitha nivelet dhe konkretisht:

- ✚ **Qëndrueshmëria në kohë**, që është një faktor kryesor për zhvillimin e turizmit në Sarandë. Vetëm një proces zhvillimi miqësor ndaj mjedisit do të jete baza për një zhvillim të suksesshëm ekonomik të turizmit.
- ✚ **Infrastruktura bazë.** Infrastruktura e kufizuar paraqet problem madhor për zhvillimin e shpejtë të turizmit në rajonin e Sarandës.
- ✚ **Sistemi i përmirësuar i informacionit.** Zhvillimi efektiv i turizmit kërkon bazë të plotë informacioni të zhvillimit të ofertës dhe kërkesës. Është e nevojshme organizimi i mbledhjes dhe analizimi eficient i të dhënave të nevojshme sipas standardeve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

✚ **Angazhimi i sektorit publik (shtetëror)/privat.** Zhvillimi i sektorit të turizmit duhet promovuar nëpërmjet sektorit shtetëror, veçanërisht në fazën fillestare. Vlerësohet i rëndësishëm koncentrimi i burimeve të kufizuara në disa zona të përzgjedhura me potencialet më të mëdha turistike dhe që kanë raportin më të mirë kosto/përfitime. Gjithashtu sektori privat do të ketë nevojë të angazhojë financime nëse do të realizohen përfitimet kryesore të turizmit.

✚ Përgatitja e një plani urbanistik.

✚ Strategji për produktin turistik.

Gjithashtu rritja e flukseve turistike nga viti në vit duhet të shikohet si detyrim më shumë për të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë të angazhuar me turizmin, sepse ka shumë për të bërë që Saranda të jetë një destinacion turistik shumë i kërkuar.

Përmirësimet në infrastrukturën energjitike të vendit dhe atë rrugore janë bërë sipas këndvështrimit prioritar të qeverisë për të mbështetur turizmin. Diversifikimi i ofertës turistike dhe venia në shërbim e turizmit të trashëgimisë kulturore përbëjnë një objektiv madhor për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.

Statistikat vitet e fundit flasin për një rritje të treguesve të turizmit në vendin tone. Po to analizojmë këto statistika me tregun e përgjithshëm në jemi shumë larg një politike dhe strategjie bashkohore, krijuese për zhvillimin e turizmit.

Zhvillimi i industrisë së turizmit karakterizohet si një prioritet për Sarandën, duke synuar që në vitet e ardhshme turizmi të jetë industria kryesore në vend. Zhvillimi i turizmit ndikon në: nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të tjera ekonomike të lidhura me turizmin, si artizanati, suvenirët etj., hapjen e vendeve të reja të punës, në përmirësimin e jetës së popullsisë së zonave pritëse, ruajtjen e trashëgimisë kulturore e natyrore etj.

Analizat tregojnë që, Saranda mund të përdorë burimet e saj në interes të turizmit gjithnjë e më shumë në të ardhmen. Strategjia e sektorit përshkruan konceptin strategjik të zhvillimit të turizmit duke dhënë drejtimet strategjike dhe zhvillimin e

produkteve turistike qe Saranda të jetë një destinacion turistik i ardhshëm në tregun turistik ndërkombetar në sjelljen e turistëve të huaj.

Tërheqja e turistëve të huaj do të influencojë që Saranda të shfrytëzojë kapacitetet turistike për të garantuar një përfitim maksimal nga futja e valutës së huaj dhe do të ndikojë në funksionimin e sektorit të turizmit në Shqipëri me të njëjtat parime me të cilat funksionon industria e turizmit në botë. Referuar analizës së gjendjes, struktura e hoteleve ekzistuese i korrespondon një kapaciteti mesatar të dhomave të hoteleve në Sarandë.

Nga këndvështrimi i marketingut të turizmit është e pamundur që ato të terheqin grupe të mëdha turistësh të organizuar në paketa turistike nga operatorët përëndimorë. Kapacitetet e këtyre bizneseve kryesisht i përgjigjen kërkesës së një klientele individuale ose të grupeve të vogla të turistëve.

Kapacitetet e reja të akomodimit të rekomanduara për zhvillim janë kalkuluar për të plotësuar kërkesën e tregjeve të huaj sipas parashikimit të netëqendrimeve si në numrin e shtetërve për strukturë akomoduese ashtu dhe standardet ndërkombetare të kërkuara nga këto tregje. Kërkesa e turistëve vendas dhe e shqiptarëve etnikë (me banim jashtë Shqipërisë) do të plotësohet nga kapacitetet ekzistuese dhe kapacitete të tjera të reja që do të përcaktohen me tej dhe zhvillohen për plotësimin e kësaj kërkesë. Për këtë qëllim drejtimit e parashtruara në Strategji kërkojnë të sigurojnë që Saranda të rrisë në maksimum potencialin e sektorëve dhe të zhvillojë turizmin në një mënyrë që të jetë i qëndrueshëm në kohë nga ana: kulturore, sociale, mjedisore dhe ekonomike.

### **Në këtë mënyrë strategjia e turizmit:**

- ✚ Ndhmon sektorin të menaxhojë rritjen në një mënyrë që të sigurohet qendrueshmeri afatgjatë;
- ✚ Ndhmon në dhënien e mënyrave të manaxhimit të konflikteve nëpërmjet rritjes së zhvillimit të turizmit dhe vlerave mjedisore, sociale dhe kulturore që janë të rëndësishme për Sarandën dhe vizitorët e saj;
- ✚ Gjen strukturat e përshtatshme brenda të cilëve investimet dhe përfitueshmëria e industrisë mund të lehtësohen dhe të rriten në maksimum;
- ✚ Redukton mbivendosjet dhe boshllëqet brenda sektorit;
- ✚ Lehtëson veprimin e operatorëve për të kryer biznes në këtë sektor;
- ✚ Siguron angazhim dhe financim për turizmin nga qeverisja qendrore dhe vendore;
- ✚ Siguron integritet të drejtimeve strategjike dhe strategjive.
- ✚ Ky koncept strategjik do të zhvillohet më tej në një proces diskutimi ndërmjet sektorëve përgjegjes të çështjeve të turizmit dhe hartimit nga ana e tyre të Planit të Veprimit.
- ✚ Plani i Veprimit do të plotësohet në terma të përgjegjësisë, kohëzgjatjes, vlerësimeve të përafërta të kostove dhe burimeve të financimit.
- ✚ Çështje të ndryshme do të zhvillohen më tej, si p.sh. përshkrimi i detajuar i strategjive për grupet e synuar të tregut turistik si ai i turizmit vendas ose turizmit të biznesit.
- ✚ Pjesa më e madhe e masave dhe veprimeve të nevojshme do të zhvillohen në vazhdimësi përgjatë disa viteve me qëllim që të vlerësohet rezultati i dëshiruar. Të punuarit së bashku i pjesëmarrësve të ndryshëm në sektorin e turizmit për të gjeneruar rezultat në procesin e zbatimit, vlerësohet si vendimtar për rezultatin e zhvillimit. Ndryshimet dhe zhvillimi i pritshëm duhet të sigurojnë që shërbimet dhe produktet cilësore të kërkuara nga turistët ofrohen në interes të të gjithëve.

Saranda ka kushte optimale për shumëllojshmëri turizmi dhe për kualitet turistësh. Drejt një arritje të tillë punohet nëpërmjet koordinimit të punëve mes drejtorisë së

turizmit dhe operatorëve turistikë. Disa aktivitete trajnuese e kualifikuese, debatet e programuara dhe seancat e shkëmbimit të përvojës brenda dhe jashtë vendit, kanë patur si objektiv pikërisht këtë, që sezoni i ri të sjellë përmirësime.

Konkurrenca është në rritje e sipër. Përvoja e fituar i shtyn operatorët që të veprojnë në këtë fushë të jenë gjithnjë e më të shumtë dhe çdo vit të sjellin diçka të re në administrim dhe menaxhim. Koha, si kudo, imponon rregulla loje. Është bërë e domosdoshme ngritja e disa shoqatave, agjencive e organizmave që kooperojnë në punët e tyre. Sot gjen kolorit të pasur të asortimentit turistik në të gjitha planet, gjen kuzhinën karakteristike vendase, por dhe kuzhina të tjera sipas shijes së klienteve, gjen shërbim hotelerie shumë cilësor, gjen mjedis të këndshëm e shërbime të tjera me kulturë dhe cilësi

Qëllimi i ardhjes së vizitorëve në Sarandë është i ndryshëm. Numri i udhëtarëve të huaj që vizitojnë Sarandën është nën mesatare krahasuar me tregun e përgjithshëm. Nga një vëzhgim i bërë në vitet 2008 dhe 2009 rezultatet e të cilit jepen në pasqyrën nr. 7, rezultoi se 50% e udhëtarëve udhëtojnë për qëllime personale, 25% për biznes, 15% nxënës shkollash dhe 10% për qëllime të tjera.

#### **Pasqyra Nr.8**

<b>Qëllimi i Udhëtimit</b>	<b>Turistë të huaj</b>		<b>Turistë vendas</b>		<b>Totali</b>	
	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>
<b>Pushime</b>	64 397	89 438	94 950	109 782	159 345	199 220
<b>Biznes</b>	321 98	44719	47 475	54 891	79 672	99 610
<b>Nxënës shkollash</b>			20.000	23.000		
<b>Të tjera</b>	12 879	17 890	18 990	21 956	31 869	39 844
<b>Totali</b>	128 793	178 875	189 899	219 564	318 687	398 439


Tashmë Saranda ka status të veçantë, pra ka përfituar status specifik me disa kompetenca prefekturë. Karakteristika të saj janë ritmet e larta të zhvillimit. Funksionon një rrjet i fuqishëm bankar privat me 10 filiale në qytet. Ushtrojnë aktivitetin e vet 160 subjekte private. Saranda disponon projekte të gatshme për të



absorbuar 60 milionë dollarë investime. Deri në vitin 2012 ishin parashikuar të zbatohen rreth 185 projekte zhvillimi, 65 prej të cilave për përmirësimin e infrastrukturës publike. Aty renditen: përfundimi i rrugës nr.5, zgjerim e rikonstruksion i rrugës hyrëse në qytet, ndërtimi i rrugës nr.1, zonës së banimit në Lëkurës, ndërtimi i shëtitores Turizëm– Kanali i Çukës, i portit, i landfillit, i aeroportit, përmirësimi i furnizimit me ujë, rikonstruksion i stadiumit të futbollit, ndërtimi i portit të jahteve, etj.

***Projektet që ndryshojnë Sarandën e sotme për një Sarandë të nesërme.***

Së afërmi Saranda do t'u ofrojë pushuesve të saj, veç bukurive të natyrës edhe gjithë aksesoret e nevojshëm të një qyteti bashkëkohor turistik. Sheshe të mëdha pushimi, hapsira të gjelbëruara, plazhe me standarde evropiane, parkingje disakatëshe, kazino, disko dhe komplekse turistike, do të jenë të gjitha në dispozicion jo vetëm të pushuesve vendas, por edhe të atyre që vijnë nga viset e huaja. Studimi i qendrës së Sarandës, do të bëjë të mundur ndryshimin e strukturës ekzistuese dhe dizenjimin e strukturave të reja në qytet.



## PËRFUNDIME


Nga analiza e bërë në këtë punim mund të arrijmë në disa përfundime që janë:

- ✚ Saranda është një destinacion turistik dhe ka një potencial turistik shumë të favorshëm për zhvillimin e disa formave të turizmit të cilat janë: lëvizje turistike rekreative për pushime bredetare. 2. Vizitat turistike, të cilat mund të jenë një ditore ose disa ditore, në grupe ose individuale. 3. Lëvizja turistike tranzite, që karakterizohet nga vizitorë që kalojnë përmes Sarandës për në brigjet e Greqisë. 4. Lëvizje për qëllime profesionale e biznesi. 5. Lëvizje turistike për qëllime kulturore.
- ✚ Ka potenciale natyrore dhe sociale kulturore e historike të shumëllojshme si, Qyteti antike i Butrintit, Syri i Kalter, Kalaja e Lekursit, Gjiri i Kakomës, Manastiri Onhezmi-Kaonia, Manastiri i 40 shenjtorëve, Manastiri i Mesopotamit.
- ✚ Historia e zhvillimit të qarkullimit turistik ka pësuar ndryshime në periudha të ndryshme ku koha po paraprin me zhvillimet që ka pësuar vendi ynë.
- ✚ Aktualisht ka një tendencë shumë pozitive të zhvillimit të lëvizjes dhe të qarkullimit turistik
- ✚ Nga viti në vit po rritet dhe përmirësohet infrastruktura turistike, ndërtimin e hoteleve, shtëpive të fshatit, kampingje të ndryshme,
- ✚ Po shtohen ndjeshëm të ardhurat nga zhvillimi i turizmit, i referohem fondeve të bëra nga Ministria e Turizmit, investimet e bëra nga sektori privat e cila përbën burim fitimi për të dyja drejtimit. Mund të them me plot bindje se e ardhmja e turizmit të Sarandës do të ketë një rritje të ndjeshme në vitet në vazhdim.

## REKOMANDIME

Dhe së fundi do të bënim disa rekomandime si më poshtë:

- ✚ Hartimi i një strategjie më specifike turistike e cila të zbatohet me përpikmëri në mënyrë që të shmangen masakrat urbane dhe natyrore
- ✚ Zgjidhja e problemeve të pronësisë në bazë të ligjit 7501 i cili shpesh bëhet pengesë për investime.
- ✚ Respektimi i planifikimit urban në mënyrë që të mos dëmtohet urbanistika e zonës më tepër
- ✚ Mbrojtja e zonave me rëndësi të veçantë historike kulturore dhe natyrore



## **BIBLIOGRAFIA:**

1. V. Koja, K. Gorica: *Bazat e Turizmit, Sh. B. L. U, Tirane, 2004*
2. V. Koja, K. Gorica: *Marketingu i Turizmit, albPAPER, TIRANE, 2007*
3. V. Koja: *Aspekte të drejtimit dhe të organizimit të rajoneve turistike, SHBLU, 2001*

### *Sitografy:*

1. *Statistic data from INSTAT <http://www.instat.gov.al/>*
2. *<http://www.mtkrs.gov.al/>*
3. *Të dhëna të marra nga Bashkia Sarandë*
4. *Hulumtime të bëra në terren (intervista , anketime)*

## **SHKURTESAT E PERDORURA**

UNESCO-(United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization.

MTKRS-( Ministria e Turizmit Rinisë dhe Sporteve)